



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:083088

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05663247

P.2023:124126

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Shpresa Hoxha, në çështjen penale kundër të pandehurve: 1. S.K i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe veprën penale Sulm nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, 2. I pandehuri M.K i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.428/2023 të datës 01.06.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, publik, më datë 15.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ardian Emini, të pandehurve, mbrojtësit të pandehurit S.K – i caktuar sipas detyrës zyrtare Avokat D. R., mbrojtjes së të pandehurit M.K – Avokate A. Sh., palëve të dëmtuara B.D, A.V dhe B.D, më datë 16.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **08.05.2024 përpiloi** këtë:

A K T G J Y K I M

I

I pandehuri S.K, me vendbanim në rrugën “...” Komuna e Kaçanikut , i lindur më datë ..., nga i ati I..., nga e ëma S... gjinisë D..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punëtor fizik,

i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 25.03.2023, rreth orës 22:30, në rrugën “Ismajl Raka ” në Kaçanik, me dashje dhe me mjet të fortë i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit B.D, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje rreth një borxhi të mëhershëm që i pandehuri ja kishte vëllait të dëmtuarit B.D, në ditën kritike sapo ishin takuar i pandehuri e kishte shtyrë në tokë dhe pastaj e ka goditur me shqelma në gjitha pjesët e trupit dhe me një dru rreth 50 cm e kishte goditur në pjesën e krahut të majtë të dëmtuarin, me ç ‘rast të njëjtit i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohëshme të shëndetit: zhvendosje (dalje nga vendi i vet) i nyjës së kyqit artikulationit të supit të krahut të dorës së majtë, të shkaktuara nga të konstatuara sipas ekspertizës mjeko ligjore të datës 26.05.2023 me numër të referencës 01/2023 dhe plotësimit të ekspertizës të datës 13.06.2023.

-Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së

Andaj duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së të pandehurin e:

G J Y K O N

1. Me dënim me burgim në kohëzgjatje nga 90 ditë (Nëntëdhjetë ditëve), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dënimin e shqiptuar i llogartet koha e kaluar në ndalim nga data 26.03.2023 deri më datë 27.03.2023.

2. Detyrohet i pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën 20€, për paushallin gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën 20.00€ dhe në emër të Fondit për

Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.

Ndaj të pandehurve S.K, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit M.K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.428/2023 të datës 01.06.2023.

- PRANOHET marrëveshja me Nr. Ndërmjetësimi 13/24 e datës 15.04.2024 e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimi e kësaj gjykate në Kaçanik në mes të pandehurit S.K dhe palëve të dëmtaura B.D dhe A.V si dhe dhe të pandehurit M.K dhe palës së dëmtuar S.K

- HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.428/2023 të datës 01.06.2023, për të pandehurin S.K, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit M.K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së pasi që lënda është zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimi.

- Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.428/2023 të datës 01.06.2023, kundër të pandehurit 1. S.K i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe veprën penale Sulm nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, 2. I pandehuri M.K i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, i ka propozuar gjykatës, që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 15.04.2024

Në këtë seancë për të pandehurit S.K i akuzuar për shkak të veprës penale veprën penale Sulm nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, 2. I pandehuri M.K i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, lënda është referuar në ndërmjetësim me pëlqimin e palëve.

Arsyetimi për pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit

Gjykata pas pranimit të aktakuzës, më datë 05.06.2023 ka marrë aktvendim procedural me të cilin e ka kthyer aktakuzën e Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.428/2023 të datës 01.06.2023 në plotësim që për të dëmtuarin B.D që të përcaktohet se nga lëndimi i rëndë trupor a ka pësuar: dobësimin e përkohëshëm ose esencial të një pjese vitale të trupit, pa aftësimin e përkohëshëm, zvogëlimin e përkohëshëm dhe esencial ose zvogëlimin e përherëshëm të aftësisë për të punuar ose dmëtimin e përkohëshëm dhe serioz të shëndetit.

Prokuroria e shtetit me parashtrësën e datës 13.06.2023, e ka plotësuar aktakuzën dhe për të dëmtuarin B.D është konstatuar se lëndimi i rëndë trupor është me pasoja të përkohëshme të shëndetit.

Gjykata pas plotësimit të aktakuzës, më datë 15.04.2024 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar.

- Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri S.K e ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i njëjti ka deklaruar se është penduar dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do te përsëris me këso lloj te veprave penale dhe i ka kërkuar falje palës së dëmtuar

- Mbrojtësi i të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturi i tijë pasi që i njëjti është i njoftuar me bëni fitet e pasojave të pranimit të fajësisë si dhe pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 242 të

KPP, i ka propozuar gjykatës që të merre aktvendim procedural për miratimin e pranimin të fajësisë. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozojmë gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar faktin se i mbrojti imë për herë të parë ka ra në ndesh me ligjin rregullimin e raportve shoqërore në raport me palët e dëmtuara si dhe faktin se i njëjti jeton në kushte të vështira financiarë. Po ashtu i ka propozuar gjykatës propozojmë gjykatës që mos të kufizohet me nenin 71 të KPRK përkatësisht në zbutjen e dënimit pasi që ekzistojnë rrethana lehtësuese posaqë rishte lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mundë të arrihet edhe me shqiptimin e një dënimit të butë përkatësisht i propozojmë gjykatës që të mbrojti time ti shqiptoj një dënim me kusht.

- Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit S.K për veprën penale se në pikën 1 të aktakuzës pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyr vullnetare dhe në përputhje të plotë në dispozitat 242 të KPRK, mbështet në provat dhe faktet që përmban aktakuza i propozoj gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë ta shpall fajtor dhe ti shqipton një dënim të parapar me kodin penal në fuqi. Me rastin e matjes të shqiptimit të dënimit si rrethanlehtësuese të mirret pranimi i fajësisë ndërsa si rrethan rënduese të mirret parasyshë dëmti i rëndë i shëndetit trupor të dëmtuarit B.D.

- Pala e dëmtuar B.D ka dhënë pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë dhe ka deklaruar se janë pajtuar për këtë raste dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të

mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit S.K plotësohen ë gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin S.K, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se: i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri është penduar për veprimet që ka bërë, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris vepra penale në të ardhmen, faktin se i kanë rregulluar raportet me palën e dëmtuar, Prokuroria e shtetit nuk ka ofruar të dhëna se i pandehuri është apo jo recidivist, sipas çertifikatës mbi dënimet të lëshuara nga Sistemi qendror i evdincës penale ka rezultuar se i pandehuri nuk është recidivist, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Gjykata duke u bazuar në të gjitha rrethanat e konstatuara posaçërisht lehtësuese dhe rënduese, dhe duke u bazuar në dënueshmërinë e vepres penale (burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet), i ka zbutur të pandehurit dënimin nën minimumin e paraparë ligjor dhe nuk ka gjetur asnjë arsye që të pandehurit ti shqiptohet dënim i kushtëzuar.

Gjykata ka vlerësuar se këtë dënim minimal krahasuar me dënueshmërinë e kësaj vepre penale duke u bazuar në të gjitha rrethanat e konstatuara posaçërisht lehtësuese dhe rënduese edhe në qëllimin e dënimit ka vlerësuar se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për kërkesat pasurore juridike

Pala e dëmtuar B.D ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës (përplilimi e ekspertizës mjeko ligjore) dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Arsyetimi për pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit

Sa i përket pikës II të këtij Aktgjykimi Gjykata me kërkesën dhe pëlqimin e palëve e ka referuar lenden në ndërmjetësim, si rrjedhojë e kësaj gjykata aprovoi marrëveshjen që është bazuar në nenin 17 par 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin Nr. 06/L-009 për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform numrit referues të ndërmjetësimi 13/24 e datës 15.04.2024

Lidhur me shpenzimet procedurale sa i përket pikës II të këtij Aktgjykimi është vendosur konform dispozitës së nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2023:124126, më datë 08.05.2024

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.